Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-240
Datë 08.05.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2018, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK), në Prishtinë, adresa; Rruga Sylejman Vokshi, nr. 50, për periudhën 25.04.2018 deri 25.04.2021 me kualifikimet:

   1.1. Ekspert i tatimor, Niveli V sipas KKK me 28 kredi të AAP

   1.2. Ekspert i lartë tatimor, Niveli V sipas KKK me 19 kredi të AAP

   1.3. Ekspert i licencuar i forenzikës financiare, Niveli sipas KKK me 18 kredi të AAP

   Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   - Plani i angazhimit të ligjeruesve të rregullt dhe kompetent.
   - Personave me nevoja të veçanta tu mundësohet një çasje e arsyeshme në certifikim.
   - Shenjat sinjalizuese në objekt si dhe mjetet për fikjen e zjarrit të jenë të certifikuara me afat valid.

   (Afati kohor: 30. 06. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucion ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofrues aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
- AKK

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa